



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:276316

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05336885

P.nr.1558/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lulzim Hoxha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: Sh., K., nga Prizreni, rr. “Zh.”, nr..... dhe F., K., nga Prizreni, rr. “Zh.”, nr....., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) Nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2357-2/19 të datës 25.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Merita Kurtishi Gaka, të akuzuarve Sh., K., dhe F., K., me datë 01.02.2024, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datën 15.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

SH., K., nga i ati dhe e ëmae lindur, i lindur me datë, në fshatin Zhur, K. Prizren, me banim në Prizren, rr. “Zh.”, nr....., ka të kryer shkollën fillore, mjeshtër ndërtimi, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

F., K., nga i ati Sh., dhe e ëmae lindur, i lindur me datë, në Prizren, me banim në Prizren, rr. “Zh.”, nr....., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

JANË FAJTORË

Të akuzuarit:

Sepse me datë 27.09.2019, rrethë orës 10:00 minuta, në Prizren, në rrugën “Zh.” nr....., në bashkëveprim me forcë dhe kanosje i pengojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, personat zyrtar – policët: S.R., V.K., F.V., dhe E.P., në atë mënyrë që kur zyrtarët policor shkojnë në shtëpinë e të pandehurve me urdhëresë për të arrestuar të pandehurin Sh. K., pas arratisjes nga Qendra e Paraburgimit, të pandehurit i pengojnë me duar duke i shtyrë zyrtarët policor për të mos i prangosur ata.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 48, 50, 69, 70, 71. 72 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPK-së.

Të akuzuarve iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- Për të akuzuarin Sh., K., për veprën penale si në dispozitiv. të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Për të akuzuarin F., K., për veprën penale si në dispozitiv. të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- OBLIGOHEN të akuzuarit që secili veç e veç ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (20) njëzet euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej (20) njëzet euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.
- Të dëmtuarit me adresë si në shkresat e lëndës për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.
- Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës-dega në Prizren, që të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me kusht.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2357-2/19, e datës 25.11.2019, ndaj të akuzuarve Sh., K., nga Prizreni, rr. “Zh.,” nr..... dhe F., K., nga Prizreni, rr. “Zh.,” nr....., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor më datë 01.02.2024, në të cilin të akuzuarve pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë që iu ngarkohej me aktakuzë.

Në shqyrtimin gjyqësor, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, konform dispozitave ligjore të nenit 322 të KPPK-së, të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave dhe në kuptim të nenit 322. par. 4. të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare deklaron: qëndroj pranë aktakuzës, kundër te akuzuarve për shkak të veprës së lartë cekur si në aktakuzë dhe i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarve, kurse si rrethanë rënduese të merr parasysh përgjegjësin penale të të akuzuarve, dashjen e tyre për kryerjen e kësaj vepre, rrezikshmërinë e veprës penale dhe faktin se të akuzuarit janë të njohur për organet e ndjekjes. Prandaj i propozojmë gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtor dhe ti dënoj me dënim meritot.

Te akuzuarit ne fjalën përfundimtare deklarojnë: se e shprehin keqardhje për veprimet e tona dhe premtoj gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla. Dhe gjithashtu kërkon nga gjykata që gjatë shqiptimit të dënimit ta shqiptoj një dënim sa më të but.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sepse me datë 27.09.2019, rrethë orës 10:00 minuta, në Prizren, në rrugën “Zh.” nr.98, në bashkëveprim me forcë dhe kanosje i pengojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, personat zyrtar – policët: S.R., V.K., F.V., dhe E.P., në atë mënyrë që kur zyrtarët policor shkojnë në shtëpinë e të pandehurve me urdhëresë për të arrestuar të pandehurin Sh. K., pas arratisjes nga Qendra e Paraburgimit, të pandehurit i pengojnë me duar duke i shtyrë zyrtarët policor për të mos i prangosur ata.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi e fajësisë prej të akuzuarve, të cilët në seancën e shqyrtimit gjyqësor vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së. Gjithashtu, në tërësi e ka vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e veprës penale të cekura më lartë, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71, 72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka shpreh keqardhje për rastin e ndodhur

dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime kundërligjore. Ndërsa si rrethanë të veçantë rënduese gjykata ka marrë parasysh, veprimet e bëra nga të akuzuarit, llojin e veprës penale, vlerat e mbrojtura, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e lartë të dashjes duke i penguar zyrtar policor në kryerjen e detyrës zyrtare, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i kanë të akuzuarit, dhe në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla të kundërligjshme.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar në neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në “parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit”.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).
- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPRK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet “për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro”.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1558/19, të dt 15.02.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.